

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DROPULL
KËSHILLI BASHKIAK

Komisioni i Përhershëm i Ekonomisë, buxhetit, auditit të brendshëm, zhvillimit strategjik.

RAPORT VENDIMMARRJE

Nr. ____ datë 25.02 2026

Nr. ____ Prot

Drejtuar: Këshillit të Bashkisë

Lenda: Vendim për shqyrtimin e projekt vendimit nr. _____ datë 27.02.2026, relacionit e dokumentat shoqërues në lidhje me propozimin për “Për një ndryshim në Vendimin e Këshillit të Bashkisë, nr.66, dt.17.12.2025, “Për miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm, Përfundimtar 2026-2028 dhe buxhetit vjetor 2026 të Bashkisë Dropull” ,

Analiza ligjore: Miratimi i ndryshimeve në buxhet bëhet në mbështetje të nenit 54, pika “dh”, ligjit nr 139/2015, “Për Vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, ligjit nr.9936, dt.26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, ligjit nr.10296, dt.08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, nenit 39, 40 dhe 41 të ligjit 68/2017, "Për financat e vetëqeverisjes vendore", Udhëzimit të M.F. nr. 08, dt. 28.02.2025, “Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2026-2028”, Udhëzimit plotësues të M.F. nr.19, dt.10.07.2025, “Për përgatitjen e programit buxhetor vendor 2026-2028”, Udhëzimit Plotësues të Ministrisë së Financave nr.02, datë 14.01.2026, “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2026”, Vendimit të Këshillit të Bashkisë nr.66, datë 17.12.2025, “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2026-2028 dhe buxhetit vjetor 2026 të Bashkisë Dropull” .

Situata aktuale e funksionit

Procesi i monitorimit dhe zbatimit të buxhetit është një proces dinamik dhe për të vendosur rishtazi ekuilibrat në aktivitetin ekonomik-financiar të Bashkisë, në përshtatje me kushtet e reja të krijuara, kërkohen ndërhyrje rregulluese, të cilat kërkojnë miratimin nga ana e organit përfaqësues, që është Këshilli Bashkiak.

Në mbështetje të Udhëzimit të Ministrisë së Financave për zbatimin e buxhetit të vitit 2026, si dhe në funksion të kuadrimit të shpenzimeve dhe të të ardhurave me Degën e Thesarit Gjirokastër lind **domosdoshmëria e kryerjes së ndryshimeve në buxhetin e vitit 2026**, të miratuar me Vendimin e K.B, nr. 66, datë 17.12.2025. Kjo ndodh, pasi në kohën e hartimit të buxhetit të vitit 2026 (muajt Nëntor -Dhjetor), vazhdonte aktiviteti ekonomik i Bashkisë, si për mbledhjen e të ardhurave të veta, ashtu edhe kryerja e shpenzimeve. Gjithashtu, nevoja e kryerjes së ndryshimeve buxhetore, që po ju paraqesim në mbledhjen e sotme, lindën si detyrim rregullues financiar të buxhetit të vitit 2026, të miratuar në mbledhjen e K.B. të muajit Dhjetor 2025, për të përmbushur më mirë, qëllimin dhe objektivat e përcaktuara në këtë buxhet , si edhe për të përfshirë në buxhet, ndryshimet që lindën, lidhur me mbylljen e aktivitetit ekonomik të vitit

2025, duke propozuar ndryshime në buxhetin e vitit 2026 për të dy komponentët bazë të tij, që janë të ardhurat dhe shpenzimet, pasi buxheti i bashkive duhet të jetë i ballancuar dhe pa fitim.

Situata financiare :

Perfshin ndryshime ne te dy komponentet e buxhetit qe jane:

A. Ndryshimet në të Ardhurat.

Duke pasur parasysh që buxheti i Bashkisë për vitin në vazhdim 2026, është paraqitur, diskutuar dhe miratuar, pa u mbyllur aktiviteti ekonomik i vitit të mëparshëm 2025, si edhe detyrimin ligjor të trashëgimit të këtij aktiviteti ekonomik, në vitin 2026, del e nevojshme, që të ketë ndryshime në buxhetin këtij viti, si në të ardhura dhe shpenzime, të cilat rrjedhin nga mosrealizimi i plotë i shpenzimeve në të gjitha programet buxhetore, të cilat nga ana e tyre paraqiten si të ardhura të trashëguara nga viti 2025, në buxhetin e vitit 2026, por edhe nga të ardhurat e mbledhura në fund të vitit, që nuk u arritën të përdoren. Konkretisht nga mbyllja e aktivitetit ekonomik të vitit 2025 dhe kuadrimi me Degën e Thesarit, të ardhurat totale paraqiten:

1. Të ardhura të planifikuara për tu realizuar nga burimet e veta, në vitin 2026, Kapitulli 5, në vlerë, 77.659.000 lek

2- Të ardhura të trashëguara nga viti 2025, nga burimet e veta, (Kapitulli 5), në vlerë, 19.160.411 lek.

Gjithsej, Kapitulli 5, (1+2), në vlerë 96.819.411 lek

3. Të ardhurat nga Buxheti qendror, nga transferta e pakushtëzuar e përgjithshme dhe ajo sektoriale (Kapitulli 1), në vlerë, 226.266.064 lek.

4. Të ardhurat e trashëguara nga viti 2025, nga transferta e pakushtëzuar e përgjithshme dhe ajo sektoriale (Kapitulli 1), në vlerë, 88.051.076 lek.

Gjithsej, Kapitulli 1, (3+4), në vlerë 314.317.140 lek

5. Të ardhura të planifikuara për tu realizuar nga grantet e huaja, (projektet), në vitin 2026, Kapitulli 2, në vlerë, 105.167.232 lek

6. Nga të ardhurat e trashëguara nga viti 2025, nga projektet e huaja, (Kapitulli 2) në vlerë, 1.394.789 lek

Gjithsej, Kapitulli 2, (5+6), në vlerë 106.562.021 lek

Gjithsej të ardhura. Kapitulli, 1+Kap.2 +Kap.3 517.698.572 lek

B. Ndryshimet në shpenzimet.

Në kushtet ku sipas ligjit, Buxheti i Njësisë të Qeverisjes së Përgjithshme duhet të jetë i ballancuar, për të gjitha të ardhurat, duhen planifikuar dhe miratuar shpenzime. Nga ana e Grupit Menaxhim, Strategji (GMS), në takimin e datës 25.02.2026, bazuar në objektivat afatmesme të Bashkisë, të percaktuara në PBA 2026-2028, që kemi miratuar, si edhe në

udhëzimet dhe legjislacionin përkatës, ku janë përcaktuar prioritetet e harxhimit të shpenzimeve në NJ.V.V., **është konkluduar që këto shpenzime, të drejtohen në:**

1. Duke u bazuar në procedurat standarte të hartimit të buxhetit, shpenzimet për investimet duhen drejtuar në investimet në proces, pra ato që janë në vazhdim nga vitet e mëparshme, **ne vlere 59.298.540 lek).**

2. Në investimet e reja të planifikuara për vitin 2026, ndryshime të cilat u diktuan nga kushtet e renda atmosferike (shirat e shumta dhe të rëmbyeshme të muajve Nëntor 2025-Janar 2026, duke u nisur nga gjëndja e vështirë e infrastrukturës rrugore në Njësinë Administrative Pogon, kërkohet ridimensionim i investimeve të vitit 2026, në aksin Poliçan-Sopik, për shtrimin me beton të segmenteve të vështira, **me një vlerë 25.208.750 lek**, për të mbuluar vetëm puntorinë dhe transportin e materialeve, pasi zgarat e hekurit dhe çimento do të vijnë si ndihmë nga ambasada e Greqisë në Shqipëri, nëpërmjet Ministrisë së Punëve të Jashtme të saj. Ky investim do të planifikohet për 3 vite, ku për vitin 2026, do bëhet e mundur vetëm për 5.039.040 lek, duke marrë një pjesë e nga ulja e investimeve të mësipërme, te vitit 2026, nga njera anë, si edhe **pakësimin e investimeve në programin e arsimit të mesëm**, (09230), për blerje laboratorit didaktik për shkollat e mesme, në vlerën **1.450.000 lek**. (Ky investim na është premtuar këtë vit nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës).

Gjithashtu, për të vënë në funksion një nga objektivat e programit të perkujdesjes sociale, që është kujdesi për moshat e treta dhe ngritja e një qendre perkujdesjeje në fshatin Dhuvian, në objektin ish vatra e kultures. Në buxhetin që miratohet për vitin 2026, kishim planifikuar një investim të tillë, si pjesëmarrje në programet e strehimit social, në vlere 9.850.000 lek. Mirepo thirrja për programet e strehimit social, që u shpall nga Ministria e Ekonomisë në fillim të këtij muaji, për vitin 2026, kishte vetëm programin e permiresimit të banesave për shtresat në nevojë, në ndryshim nga vitet e mëparshme. Në këto kushte, për të bërë të mundur këtë investim, duhet që këto fonde të kalojnë nga programi i strehimit social, 10661, tek programi 10430 (kujdesi social), që në sinkron me shpenzimet që kemi parashikuar në PBA për vitin 2027, në këtë program me 18.883.823 lek për këtë vit, të mund të realizohet ky projekt me burimet tona. Prandaj kërkojmë miratimin Tuaj për transferimin e shumës **9.850.000 lek** nga programi i strehimit social (10661), në programin e perkujdesjes sociale, (10430), si edhe shtesën prej 2.276.177 lek për vitin 2026.

3. Në shpenzime për investime për të siguruar pjesëmarrjen e Bashkisë në projektet e huaja që janë : “EXTROVERT ROADS 2.0”, “GREEN ACTIONS FOR PRISTINE SKIES (GAPs)” dhe “EPIRUS MEDEYE”, (nga Kapitulli 1), pasi janë fonde, që kanë ardhur vitin e kaluar nga Agjencia Shtetërore e Programimit Strategjik dhe Kordinimit të Ndihmës së Huaj (SASPAC), pas kërkesës tonë për të mbuluar pjesëmarrjen e Bashkisë (20%), në Programet e Huaja të cituara më lart), në vlerë 29.474.025 lek.

4. Për të mbuluar shpenzimet tek programi i huaj , “IPA-ADRION00215 - “Adopting CCAM 2ZERO through ADRION” (ADCCAM2ZERO)”, të cilat janë të trashëguara nga viti 2025, në Nga Kapitullin 2, në vlerë 1.394.789 lek.

5. Për të mundësuar zbatimin e VKM, nr.103, datë 11.2.2026, “Për disa ndryshime në Vendimin nr.328, datë 31.05.2023, të Këshillit të Ministrave , “Për klasifikimin e funksioneve , grupimin e njësisive të vetqeverisjes vendore, për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të

funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë, të njësisve të vetqeverisjes vendore”, të ndryshuar, VKM, nr.104, datë 11.02.2026, “Për një ndryshim në Vendimin nr.419, datë 26.6.2024, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e vlerave për sejcilin element përbërës të pagës bruto mujore të punonjësve të shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin”. Sipas vendimeve të mësipërme, shtesat në pagat, të cilat do miratohen me vendim të veçantë, Tuajin, të paraqitura nga Drejtoria e Shërbimeve të Brendshme, do duhet të mbulohen nga fondet e veta të Bashkisë.

Nga llogaritjet e bëra nga Drejtoria e mësipërme, kërkohen 16.874.776 lek, për të cilat do duhen gjetur burime nga pakësimi i investimeve të reja të planifikuara në vitin 2026, konkretisht nga pakësimi i investimeve në programin e MZSH, (03280) për rikonstrukcionin e godinës së MZSH, pjesërisht të blerjeve të pajisjeve dhe blerjes së mjetit të ri në vlerën 6.045.677 lek; në programin e Kullim-Ujitjes, (04240) për blerjen e mjetit të ri, në vlerë 2.100.000 lek; në programin e Pyjekullota (04260), për rikonstrukcion rezervuar malor, për bagëtinë, në vlerë 2,358.000 lek, në Programin e shërbimeve publike, (06260), pakësim të zgjerimit të varezave publike të fshatrave të Bashkisë, në vlerë 7.312.000 lek dhe blerje mjete mekanike elektrike 1200.000 lek.

6. Për nevoja të pagesës së së lëvrimin të mallrave (karburant), për kontratën e vitit 2025, kërkohen të transferohen në programet 04520, 04240, 09230 dhe 10430, Kapitulli 1, artikulli 602, gjithsej 650.000 lek, duke i pakësuar nga programi 1110, nga kapitulli dhe artikulli i njëjtë, pasi këto fonde ishin të obliguara tek Kapitulli 1 (granti) për vitin 2025 dhe për vitin 2026, nuk kemi planifikuar shpenzime materiale.

7. Ndryshimet në buxhet, u bënë edhe për të saktësuar të gjitha shpenzimet me burim nga grantet e huaja, (kapitullit 2), për projektet e huaja, pasi në këtë fazë, janë lidhur një pjesë e mirë e kontratave dhe janë përcaktuar, në këtë mënyrë edhe ecuria e tyre, në funksion të disbursimit të fondeve nga donatorët e huaj dhe paraqitet në tabelën e shpenzimeve nga kapitulli 2, bashkangjitur.

Drejtoria / sektori pergjegjes:

Drejtoria e Finances dhe buxhetit, pas vendimmarrjes se Grupit te Menaxhimit strategjik te Bashkise.

Monitorimi dhe raportimi :

Komisioni i Ekonomise, buxhetit, auditit te brendshem, zhvillimit strategjik., dhe keshilli bashkiak, monitorojne ecurine dhe realizimin e aktit, dhe mund te kerkojne raportim periodik per ndjekjen dhe realizimin e ndryshimeve te miratuara te buxhetit.

Impakti social / grupet që preken: Ky projekt vendim, impakton zhvillimin ekonomik të Bashkisë, nëpërmjet rritjes së investimeve dhe thithjes së fondeve nga projekte, ose programe evropiane.

A është objekt i konsultimit publik:

Ky akt i Keshillit te Bashkise, nuk eshte objekt i konsultimit publik, para se te miratohet nga Keshilli i Bashkise.

Komisioni i Përhershëm i “Ekonomise, buxhetit, auditit te brendshem, zhvillimit strategjik.”, i mbledhur me datën ____ / ____ / 2026, shqyrtoi projekt vendimit nr. ____ datë ____ / ____ 2025, relacionit e dokumentat shoqërues në me propozimin për “Miratimin e destinacionit të

përdorimit të fondit të Grantit të Bazuar në Performancë të vitit 2025, me burim financimin e huaj”, paraqitur nga Kryetari i Bashkisë.

Pas shqyrtimit të projekt vendimit dhe materialeve shoqëruese,

Komisioni me shumicë votash,

VENDOSI

1. T’i propozojë Këshillit Bashkiak:

a) kalimin e projektaktit në Mbledhjen e Këshillit për vlerësim të mëtejshëm dhe shqyrtim

b) miratimin e projektaktit

c) refuzimin e miratimit të projektaktit

d) miratimin e projekt-aktit me ndryshimet si vijon:


✓ Pika 1 (një) e projekt vendimit të ndryshoje në “ -----“

✓ Pika 4 (katër) e projekt vendimit të ndryshoje në “ -----“

✓ Tabela nr. 6 (gjashtë) e projekt vendimit të ndryshoje në “ -----“

✓ Paragrafi 15 (pesëmbëdhjetë) i projekt vendimit të ndryshoje në “ -----“

Bashkëlidhur **argumentat e vendimmarrjes dhe mendimi i pakicës** i paraqitur në procesverbalin e mbledhjes së Komisionit.

Aleksandër Boboli  Kryetar i Komisionit
(emri, mbiemri, firma)

Elioma Mano  Sekretar i Komisionit
(emri, mbiemri, firma)

Datë ____ / ____ 2026

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DROPULL
KËSHILLI BASHKIAK

Komisioni i Përhershëm i Ekonomisë, buxhetit, auditit të brendshëm, zhvillimit strategjik.

RAPORT VENDIMMARRJE

Nr. _____ datë 25.02.2026

Nr. _____ Prot

Drejtuar: Këshillit të Bashkisë

1. **Lenda:** Vendim për shqyrtimin e projekt vendimit nr. 9 datë 27.02.2026, relacionit e dokumentat shoqërues në lidhje me propozimin për “Miratimin e realizimit të buxhetit (të ardhurave dhe shpenzimeve faktike nga burimet e veta, të vitit 2025, “.

Analiza ligjore: Miratimi i realizimit të buxhetit (të ardhurave dhe shpenzimeve faktike nga burimet e veta, të vitit 2025 është në mbështetje të nenit 44 të Ligjit Nr 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, nenit 65 të Ligjit Nr 9936, datë 26.06.2008, “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; nenit 48 të Ligjit 68/2017, datë 27.04.2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Nr. 22, datë 30.07.2018, “Për Procedurat Standarte të monitorimit të buxhetit të njësisë të vetëqeverisjes vendore », Vendimit të Këshillit të Bashkisë Nr. 55, datë 19.12.2024, “Për miratimin e Programit Buxhetor afatmesëm 2025-2027 dhe buxhetit të Bashkisë Dropull për vitin 2025”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Bashkisë Nr. 56, datë, 19.12.2024, “Për Miratimin e kalendarit të programit buxhetor afatmesëm 2026-2028 dhe monitorimit të tij për vitin 2025”

Situata aktuale e funksionit

Realizimi faktik i të ardhurave nga të gjitha burimet e veta vendore, që përfshin: të

ardhurat e veta, të ardhurat nga buxheti qendror dhe të ardhura të trashëguara nga viti 2024, rezulton në vlerën 368.459 mijë mijë lek, kundrejt planit të ndryshuar prej 380.493 mijë lek, ose 97% me një mosrealizim të vogël në masën 3%, ose 12.034 mijë lek, ndërsa krahasuar me vitin e mëparshëm 2024, realizohen në masën 123%, ose 69.879 mijë lek më tepër. Ndikim, në këtë të fundit kanë dhënë, kryesisht, por jo vetëm:

Së pari, tejkalimi i të ardhurave nga buxheti qendror (133%), ose 62.831 mijë lek; brenda tyre, transferta e pakushtëzuar e përgjithshme (143,2%) dhe ajo sektoriale (109,2%).

Së dyti, nga të ardhurat totale të trashëguara (150%), ose 16.407 mijë lek.

Të ardhurat nga taksat Lokale realizohen në masën 94% kundrejt planit dhe 113%, në krahasim me vitin e mëparshëm. Mosrealizimi në krahasim me planin vjen kryesisht, nga taksa e ndikimit në infrastrukturë dhe taksa e tabelës. E para realizohet në masën 27%, ndërsa e dyta, në masën 79%, për shkak të mos miratimit nga KRRTRSH të PPV të Bashkisë, mospasjes së kërkesave të reja për leje ndërtimi, Ndërsa mosrealizimi, në krahasim me planin dhe vitin e kaluar të taksës së tabelës, vjen për shkak të heqjes së tabelave të biznesit nga rruga nacionale Kakavi-Gjirokastër nga ana e IKMT. Në kufijtë e realizimit, në krahasim me planin dhe me rritje nga viti i mëparshëm, janë taksat mbi pasurinë e paluajtshme (ndërtesën, truallin dhe tokën bujqësore). Kështu të tria këto taksa realizohen në masën 98% dhe me vitin e mëparshëm 101%.

Te ardhurat nga taksat e ndara, realizimi, në krahasim me planin është 155% dhe me vitin e mëparshëm 137%. Tejkallimet paraqiten në të dyja zërat, që janë nga taksa vjetore e mjeteve të përdorura dhe të ardhurat nga taksa mbi të ardhurat personale (vjen nga DPT), si rezultat i rritjes së pagave gjatë vitit 2025.

Te ardhurat nga tarifat vendore, shohim një mosrealizim të vogël, në krahasim me planin. Me konkretisht është aritur realizimi në masën 92% të planit. Kemi një mosrealizim në tarifen vendore të urbanistikës në vlerën 997 mijë lek, pasi kjo tarifë është e lidhur ngushtësisht me lejet e reja të ndërtimit, edhe pse nga ana e Agjensisë së Kadastrës nuk kërkohet më shkresë përcjellëse për verifikimin e pasurive për kërkesat për hipotekim të qytetarëve.

Tek pjesa e katert e tabelës në të cilën janë **te ardhurat e tjera** shohim një tejkallim të vlerave, pothuajse në të gjitha zërat, me përjashtim të artikullit “shitja e mallrave dhe shërbimeve”, ku gjatë vitit 2025, nuk realizuam prodhimin e druve të zjarrit, në vlerën 3.640 mijë lek.

Realizimi i shpenzimeve sipas programeve nga burimet e veta (ardhurat e veta, transferta e pakushtëzuar e përgjithshme dhe sektoriale dhe të ardhurat e trashëguara), (bashkangjitur), shikojmë se për totalin e programeve buxhetore (gjithsej 16), gjatë vitit 2025 realizuam gjithsej 259.852 mijë lek në fakt, nga 372.729 mijë lek, në plan (i ndryshuar) ose 70%. Në qoftë se realizimin e shikojmë në krahasim me vitin e kaluar 2024, jemi në masën 105%. Duke komentuar realizimin e shpenzimeve faktike sipas programeve buxhetore, vërejmë se për Bashkinë tonë, vazhdon të mbetet prioritet programi 04520 (rrugë rurale), kjo lidhet me mbulimin e një teritori të madh gjeografik (467km²) dhe nevojën e aksesit në shërbime të komunitetit në zonat e thella rurale të Njësisë administrative Pogon dhe Dropull i Sipërm. Gjithashtu, i pari për nga niveli i shpenzimeve të planifikuara dhe të realizuara është programi buxhetor 01110 (planifikim, menaxhim, administrim), i cili kontribon në realizimin e objektivave për funksionimin e organeve përfaqësuese dhe ekzekutive, për një zhvillim të qëndrueshëm të administratës civile në shërbim të komunitetit, stafit të Kryetarit dhe Këshillit bashkiak. Ndërsa planifikimi dhe realizimi për shërbimet vendore në funksion të gjithë komunitetit, të marra së bashku, që përfshin mbrojtjen nga zjarri dhe mbrojtjen civile, kullim-ujitje, pyje-kullota, rruge

rurale, menaxhimin e mbetjeve urbane, shërbimet publike dhe ato kulturore përfaqësojnë rreth 51% të totalit të tyre.

Në realizimet e shpenzimeve në krahasim me planin (buxhetin), sipas artikujve (600, 601, 602, 604, 606 dhe 230, 231), vërrehet se kemi një realizim të shpenzimeve për paga, sigurime shoqërore dhe kujdesi për individë, por relativisht me mosrealizime paraqiten shpenzimet për investime dhe ato për mallra dhe shërbime.

Mosrealizimet e shpenzimeve për investime për vitin 2025, për veprat kryesore, si Pjesëmarrja në Rehabilitimin e Digës Pepel-1, Rehabilitimi i kanalit vaditës nga Rezervuari i Pepelit dhe Pjesëmarrje në Ndërtim palestres rikonstruksioni i Shkollës së Mesme të Bashkuar Dervician, kanë ndodhur për shkak të lidhjes së vonët të kontratave me subjektet fituese të prokurimeve, por edhe të kushteve të vështira atmosferike, shirave të rëmbyeshëm, qysh prej muajit Nëntor të vitit të kaluar dhe nuk premtoi koha për pagesën e tyre brenda vitit 2025, gjë që do realizohet këtë vit, nga shpenzimet e trashëguara në 3-mujorin e parë të vitit 2026..

Po kështu realizimi i shpenzimeve në artikujt 606 dhe 604 që kanë të bëjnë me shpenzimet e kujdesit për individët, familjet dhe transfertat lidhur me detyrimet buxhetore të Bashkisë për akademinë sportive dhe shoqatat kulturore, paraqitet i kënaqshëm (84%).

Gjithashtu është i mërëkuptuar, mosrealizimi i artikullit 609 (fondi rezervë, fondi i emergjencës), pasi ato përdoren për të financuar aktivitete, që nuk mund të parashikoheshin në kohën e hartimit të buxhetit, pasi përdorimi i këtyre fondeve.

Situata financiare :

Në përputhje me objektivat e caktuara, në kuadër të PBA 2025-2027, buxheti i vitit 2025, dhe i viteve në vazhdim të PBA 2026-2028, kanë qënë dhe janë të ballancuar dhe të gjitha angazhimet dhe objektivat e ndermarra nga ana e organeve përfaqësuese dhe ekzekutive të pushtetit tonë vendor (Kryetari dhe Këshilli Bashkiak), kanë qënë dhe janë brenda mundësive të burimeve të financimit. Të gjitha shpenzimet e realizura gjatë periudhës së vitit 2025, në të gjitha programet buxhetore të shpenzimeve që menaxhon dhe zbaton Bashkia jonë, janë brenda limitit të miratuar të shpenzimeve të çdo programi (sipas buxhetit të aprovuar nga Këshilli Bashkiak). Bashkia jonë nuk paraqet vështirësi financiare dhe as rezik për tu ndodhur në kushtet e vështirësisë financiare në periudha afatmesme. Nuk kemi detyrime të prapambetura të pashlyera, të pabuxhetuara, të cilat mund të çënojnë nivelin aktual dhe të ardhshëm të shpenzimeve, me ndikim në sasinë dhe cilësinë e shërbimeve të ofruara për komunitetin tonë.

Kështu, realizimi i buxhetit (të ardhurave dhe shpenzimeve faktike nga burimet e veta, të vitit 2025, si dhe të ardhurave të trashëguara për vitin 2026), paraqitet, si më poshtë:

Të ardhurat të realizuara për vitin 2025

•	Të ardhura të trashëguara nga viti 2024 për vitin 2025.....	13.509.066,64 lek
•	Te ardhura te trasheguara nga 2024, nga grante te huaja	1.394.789.45
•	Granti i trashëguar nga viti 2024, në vitin 2025.....	35.732.386,44 lek
•	Të ardhura nga transferta e pakushtëzuar dhe sektoriale....	250.853.106,82 lek
*	Të ardhurat të krijuara në vitin 2025.....	66.969.155,84 lek

Shuma

368.458.505,19 lek

Shpenzimet e realizuara për vitin 2025.

•	Paga personeli	150.078.302 lek
•	Sigurime shoqërore e shëndet.	24.574.729 lek
•	Mallra e shërbime të tjera	48.658.088 lek
•	Investime	27.808.152,40 lek
•	Kujdesi social per individë	5.405.770 lek
•	Transferta (A.Sport..K.Q..)	3.327.187 lek.

Shuma

259.852.228,40 lek.

Të ardhura të trashëguara për vitin 2026 (Ardh.-Shpenz.) **108.606.276,79 lek**

Drejtoria / sektori pergjegjes:

Drejtoria e Finances dhe buxhetit, pas vendimmarrjes se Grupit te Menaxhimit strategjik te Bashkise.

Monitorimi dhe raportimi :

Komisioni i Ekonomise, buxhetit, auditit te brendshem, zhvillimit strategjik., dhe keshilli bashkiak, monitorojne ecurine dhe realizimin e aktit, dhe mund te kerkojne raportim periodik per vazhdimin e ndjekjes se buxhetit te vitit 2026.

Impakti social / grupet që preken: Ky projekt vendim, kerkon qe nga ana e Ekipeve të Menaxhimit të Programeve dhe Drejtuesve të tyre të punohet më tepër për përgatitjen e dokumentacionit teknik dhe ekonomik, që bën të mundur realizimin e plotë të shpenzimeve në investimet, aktivitetet, mallrat dhe shërbimet e planifikuara për vitin 2026 dhe në vazhdim, ndjekjen e cilësisë dhe efektivitetit të këtyre veprimtarive, si dhe zhvillimin e analizave periodike lidhur me ecurinë e tyre, me synim arritjen e objektivave bazë të Bashkisë, por edhe të objektivave konkretë të çdo programi dhe aktiviteti buxhetor. Sugjerojmë që pas miratimit të Raportit nga Këshilli i Bashkisë, të përcaktohen detyrat për të ardhmen, në kuadër të monitorimit të realizimit të buxhetit të vitit 2025, si edhe hartimit të PBA 2027-2029

A është objekt i konsultimit publik:

Ky akt i Keshillit te Bashkise, nuk eshte objekt i konsultimit publik, para se te miratohet nga Keshilli i Bashkise.

Komisioni i Përhershëm i “Ekonomise, buxhetit, auditit të brendshëm, zhvillimit strategjik.”, i mbledhur me datën ____ / ____ / 2026, shqyrtoi projekt vendimit nr. ____ datë ____ / ____ 2025, relacionit e dokumentat shoqërues në me propozimin për “Miratimin e destinacionit të përdorimit të fondit të Grantit të Bazuar në Performancë të vitit 2025, me burim financimin e huaj”, paraqitur nga Kryetari i Bashkisë.

Pas shqyrtimit të projekt vendimit dhe materialeve shoqëruese,

Komisioni me shumicë votash,

VENDOSI

1. T’i propozojë Këshillit Bashkiak:

a) kalimin e projektaktit në Mbledhjen e Këshillit për vlerësim të mëtejshëm dhe shqyrtim

b) miratimin e projektaktit

c) refuzimin e miratimit të projektaktit

d) miratimin e projekt-aktit me ndryshimet si vijon:


✓ Pika 1 (një) e projekt vendimit të ndryshoje në “ _____”

✓ Pika 4 (katër) e projekt vendimit të ndryshoje në “ _____”

✓ Tabela nr. 6 (gjashtë) e projekt vendimit të ndryshoje në “ _____”

✓ Paragrafi 15 (pesëmbëdhjetë) i projekt vendimit të ndryshoje në “ _____”

Bashkëlidhur **argumentat e vendimmarrjes dhe mendimi i pakicës** i paraqitur në procesverbalin e mbledhjes së Komisionit.

Aleksander Bobali  **Kryetar i Komisionit**
(emri, mbiemri, firma)

Eliana Mano  **Sekretar i Komisionit**
(emri, mbiemri, firma)

Datë ____ / ____ 2026